

VENDIM
Nr. 178, datë 25.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 145, DATË 20.2.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJESEMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË SHTABIN “EUFOR”, NË
KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK “ALTHEA”, TË BASHKIMIT EVROPIAN,
NË BOSNJË-HERCEGOVINË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 145, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat, i cili fillon të llogaritet nga data 26 shkurt 2015. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë, së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama